



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 613/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lulzim Bllaca, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e Lulzim Bllacës, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Obiliq, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me shenjë ZL.Anr.613/2017, ZL.Anr.614/2017 dhe ZL.Anr.631 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat ZL.Anr.613/2017 dhe ZL.Anr.614/2017 dhe ZL.631/2017 me datën 09.11.2017 në ora 12:10, nga parashtruesi i ankesave Lulzim Bllaca, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Obiliq, nga radha e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega Obiliq. Në ankesat e parashtruara nga ankuesi pretendohet se në vendvotimin 1508/01D, 1519/01R, 1501/01R, 1502/01R, 1507/01R dhe 1508/01R në Kryshevc, komuna e Obiliqit, i janë keqpërdorur votat dhe se i mungojnë votat e votuesve të tij. Kërkon nga PZAP-i që të rinumërohen votat në vendvotimet e cekura në ankesë.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur formularin e votave të kandidatëve.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.613/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të tri ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesit me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë për asnjë vendvotim me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesat e ankuesit i konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuara dhe e të pa argumentuara dhe si të tilla ankesat e ankuesit i refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.613/2017 më datën 10.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*